

“AKADEMIA E SHKENCAVE” - TIRANË

PËRMBYRTIA

01 Të dhëna gjuhësore dhe historike

02

**“AKADEMIA E SHKENCAVE”
TIRANË**

03

04

05

06



“AKADEMIA E SHKENCAVE” - TIRANË

PËRMBAJTJA

01 Të dhëna gjeografike dhe historike

02 Gjendja ekzistuese

03 Vendndodhja

04 Materiale grafike

05 Foto të gjendjes ekzistuese

06 Propozimi

“AKADEMIA E SHKENCAVE” - TIRANË

Të dhëna gjeografike dhe historike

01

Ndërtesa e cila në vitet 1928 – 39 ishte Pallati Mbretëror, është ajo ku prej viteve '70 ka zënë vend Akademia e Shkencave. Më përpara akoma, (në vitet 1920 – 26), ajo ka qenë selia e Parlamentit shqiptar, dhe për një periudhë të shkurtër selia e Këshillit të Ministrave. Aty është shkruar një pjesë e rëndësishme e historisë së shtetit shqiptar. Pallati është ndërtuar në fillim të shekullit XX dhe ishte pronë e Zija bej Toptanit. Hyrja për në ndërtesë në periudhën që kjo ishte selia e Parlamentit, ka qenë nga perëndimi, ndërsa hyrja nga veriu është hapur kur godina u shndërrua në Pallat Mbretëror. Vendosja e Mbretit Zog I në këtë ndërtesë, u bë në vitet 1927-28. Përpara se ai të akomodohej aty, Pallatit iu bë një rinovim i përgjithshëm, nën kujdesin e arkitektëve Kristo Sotiri dhe Scullati. Studioja e Mbretit u sistemua me mobilje të stilit të 1500-s, nga Ferruccio Montanari. Në vitet '30 të shekullit XX, në kopshtin (lulishten) që qarkonte Pallatin Mbretëror, kishte një koleksion të madh dhe të rrallë lulësh. Shënojmë se Mbreti i paguante qira pronarit Zija Toptani.

Në katin e parë djathtas është salla e bibliotekës së Akademisë, ku ndodhet një oxhak i vjetër; aty ka qenë vendosur stema e Mbretërisë, sot e zëvendësuar me stemën e Akademisë së Shkencave. Përballë sallës së bibliotekës ndodhej një sallë tjetër e madhe, e cila që kur s'mbahet mend, është ndarë në dhoma. Në kujtimet e tij, Zoi Xoxa e ka përshkruar dy herë studion e Mbretit; herën e parë kur shkoi në audiencë në vitin 1928: “Kjo ishte një dhomë nja 10 metra e gjatë dhe nja 7-8 metra e gjerë. Kishte dy dyer: një që komunikonte me sallonin e pritjes dhe ishte dera nga hymë ne, dhe tjetra në koridorin. Kishte tri dritare të larta dhe të ngushta, me korniza dhe perde të rënda. Ishte tejteje me një qilim persian dhe pranë mureve, veshur me tapiceri, kishte disa rafte me libra. Në krye: një tryezë e madhe prej arre me dy telefona nga krahu i majtë. Në murin sipër tryezës, një portret i madh me kornizë të praruar i Nënës Mbretëreshë. Përballë tryezës: dy kolltukë prej lëkure të zezë”. Me rastin e audiencës në vitin 1937, herë e dytë, Xoxa shkruan kështu për studion: “S’kishte ndryshuar aspak: po ajo dhomë e gjatë me tri dritare nga veriu, e shtruar me qilima persiane, me disa rafte me libra gjatë mureve dhe me një tryezë të madhe në krye, duke pasur përsipër një kuadër shumë të madh të Nënës Mbretëreshë”. Këtu është fjala për sallën e audiencave të Mbretit në katin e parë. Dhoma private e Mbretit ka qenë në katin e dytë dhe këtë e dëshmon Mehdi Frashëri; kur shkuan së bashku me kryeministrin Pandeli Evangjeli u paraqitën tek Mbreti “jo në dhomën e audiencës, por në odën e tij private në katin e dytë”. Dhoma e gjumit e Mbretit sot është zyra e Kryetarit të Akademisë së Shkencave.

Gjendja ekzistuese

02

Godina ka një planimetri thujse drejtkëndore të rregullt. Kjo godinë ka arritur në ditët tona mjaft e transformuar, megjithëse ruan substancën origjinale të saj. Transformimet kanë ardhur si pasojë e përdorimit të saj për një periudhë të gjatë kohe për qëllime të ndryshme, të cilat kanë kërkuar adoptime, shtesa si dhe transformime në interior për t'iu përshtatur funksioneve të ndryshme nga ai fillestar.

Salla e madhe, ku sot zhvillohen konferenca (në jug të Pallatit), fillimisht nuk ka ekzistuar dhe është ndërtuar me rastin e 25 vjetorit të shpalljes së pavarësisë, në vitin 1937, gjë që konstatohet dhe në fotografi të kohës. Asgjë nuk i ka mbetur sallës, nga dekori mbretëror, veç vëllimit të saj madhështor. Ndërtesa mbulohet me një çati me katër kullime e mbuluar me tjegulla.

Duke iu referuar fotove të vjetra, fasada veriore ka pësuar ndryshime. Sot mungojnë dy dritaret e murosura me kornizë në katin përdhe. Gjithashtu ndryshime në fasadë kanë pësuar dhe ato nga ana lindore dhe perëndimore. Gjatë funksionit të godinës si Parlament, si fasadë kryesore ka shërbyer ajo perëndimore, ku hyrja ishte në anën e majtë të ballkonit të sotëm. Këto shkallë u mbyllën pas atentatit të kryer ndaj Mbretit Zog në vitin 1923. Erkeri në fasadën lindore ka pësuar shndërrime duke u mbështetur në tre kolona me dimensione 40x35 cm duke formuar një dalje ballkoni në katin përdhe, i cili sot nuk është i aksesueshëm.

Gjithashtu, kjo godinë ka pësuar ndryshime dhe në interior. Disa prej elementëve arkitektonik dekorativ kanë pësuar ndryshime ose kanë humbur tërësisht. Tavani i dekoruar i bibliotekës në katin përdhe ruhet plotësisht, por ka pësuar ndryshime nga ngjyrat origjinale. Salla përballë bibliotekës është ndarë në tre ambjente zyrash. Me këtë ndarje edhe tavani i dekoruara ka pësuar transformime. Zyra e parë e ruan komplet kornizën dhe rozenë në tavan, ndërkohë që zyra e dytë ruan vetëm rozenë kryesore me motive floreale por nuk ruan kornizën dhe zyra tre nuk ruan asnjë element dekorativ të tavanit.

Në katin e parë, dhoma e cila ruhet më mirë është zyra e Kryetarit të Akademisë së Shkencave (dhoma personale e Mbretit Zog). Tavani i dekoruar është në gjendje të mirë. Ruhet dhe shandani origjinal.

Ndërhyrje janë realizuar dhë në dyshemetë e brendshme të ndërtesës, në të është zëvendësuar dyshemeja prej dërrase me pllaka majolike ose parket laminat. Të gjitha dritaret prej druri janë zëvendësuar me dritare duralumini.


Problemi kryesor në këtë godinë, e cila kërkon ndërhyrje sa më të shpejta është çatia e degraduar. Shenjat e lagështisë janë shfaqur kudo nëpër tavanet e katit të parë. Suvatimet kanë pësuar plasaritje. Pastrimi i fasadave dhe i kornizave është i nevojshëm.

Materiale grafike


04

Bashkëngjitur plane të objektit.

- Planimetri Kati Përdhe



- Planimetri Kati Parë



- Fasada Perëndimore






Foto të gjendjes ekzistuese

05

Bashkëngjitur foto aktuale të objektit.



Histori dhe Gazetari Dëshirë - "TIRANA E VJETËR, Një histori e trashëguar" 2014



Propozimi

06

Duke vlerësuar rëndësinë historike dhe arkitektonike të objektit si dhe potencialin arkeologjik të zonës përreth tij, bazuar në Ligjin nr. 9048 “Për Trashëgiminë Kulturore” (i ndryshuar), datë 07.04.2003, neni 26, propozohet kryerja e procedurave përkatëse ligjore për shpalljen Monument Kulture të Kategorisë I.

Përgatiti:

Endrita Mulleti

Ueda Gruda

Edlira Nikaj

Lorin Dvorani

Bibliografia:

Gazmend Baku – “TIRANA E VJETËR, Një histori e ilustruar”, 2014